

IRÈNE NÉMIROVSKY

JEZABEL

Roman

Përktheu nga frëngjishtja Diana Çuli

Në bankën e të akuzuarve hyri një grua. Ishte ende e bukur, ndonëse e zbehtë, e ndonëse dukej e tronditur dhe e lodhur: sytë, me një formë magjepsëse, i kishte të veshur nga një perde lotësh dhe buzët i vareshin anash. Flokët, fshehur nën kapelën e zezë, nuk i shiheshin.

Vuri duart tek qafa me një lëvizje mekanike, si të donte të prekte gjerdanin e gjatë të perlave që dikur ia zbukuronte, por qafa ishte e zhveshur; duart ngurruan; tërhoqi me ngadalë dhe plot trishtim gishtërinjtë dhe nga turma e shqetësuar, që po ndiqte me sy çdo lëvizje të saj, erdhi një mërmërimë e shurdhët.

– Juria dëshiron t’iu shohë fytyrën, - tha kryetari. – Hiqeni kapelen.

Gruaja e hoqi dhe, përsëri, të gjitha shikimet u ngulën mbi ato duar të zhveshura, të imta, të përkryera. Shërbëtorja e saj, e ulur në radhën e parë midis dëshmitarëve, bëri instinktivisht përpara, si të donte t’i shkonte në ndihmë, por pastaj u ndërmend se ku ndodhej; u skuq, e turbulluar.

Ishte një ditë vere pariziane, e ftohtë dhe e zbehtë; shiu rrëshqiste përgjatë dritareve të larta; drita e irnuar e rrebeshit binte mbi veshjet me dru të vjetruar të mureve, rombet e pruar të tavanit e togat e kuqe të gjykatësve. E pandehura vështroi anëtarët e jurisë ulur përballë saj, pastaj sallën, të mbushur në çdo cep, plot me grumbuj njerëzish, që ngjisheshin pas njëri tjetrit.

Kryetari pyeti:

– Emrin dhe mbiemrin?... Ku keni lindur?... Mosha?

Askush nuk e dëgjoi pëshpërimën që doli nga goja e së pandehurës. Në sallën e gjyqit, disa gra folën me zë të ulët:

– U përgjigj... Po çfarë tha?... Po ku ka lindur?... Nuk e dëgjova... Sa vjeç është?... Nuk dëgjohet asgjë!...

Flokët e saj vinin të butë, në një ngjyrë të verdhë të çelët; ishte veshur në të zeza. Një grua tha nën zë:

– Sa e bukur qenka!, pastaj psherëtiu me kënaqësi, si të ishte në teatër.

Publiku në këmbë s'arriti ta dëgjonte mirë akuzën. Kalonin dorë më dorë gazetat e ditës, të cilat botonin në faqe të parë përshkrimin e të akuzuarës dhe përmbledhtazi ndodhinë e krimit.

Gruaja quhej Gledis Eizenah. Akuzohej se kishte vrarë të dashurin e saj, Bernard Martën, njëzet vjeç.

Kryetari filloi pyetjet.

– Ku keni lindur?

– Në Santa-Paloma.

– Është një fshat që ndodhet në kufirin midis Brazilit dhe Uruguait, - u shpjegoi kryetari anëtarëve të jurisë. – Cili është mbiemri juaj i vajzërisë?

– Gledis Burnera.

– Por këtu s'do merremi me të kaluarën tuaj... Me sa jam në dijeni, ju e keni kaluar fëmëninë dhe rininë duke udhëtuar në vende të largëta, ku ka pasur shpesh trazira sociale, e ku e kemi pasur të pamundur të kryejmë hetimet e duhura. Për këtë arsye, për sa i përket asaj periudhe, shtrëngohemi të mbështetemi kryesisht në thëniet tuaja. Në hetuesi keni deklaruar se jeni e bija e një armatori nga Montevideo, por ju vetë keni lindur larg prej tij dhe s'e keni njohur atë kurrë, meqenëse nëna juaj Sofi Burnera, u largua prej tij dy muaj pas martesës. Saktë?

– Saktë.

– Keni udhëtuar shpesh gjatë fëmënisë. U martuat kur ishit ende një fëmijë, sipas zakoneve të vendit; u martuat me financierin Riçard Eizenah; burri iu vdiq më 1912. I përkisni asaj pjese të shoqërisë që është gjithnjë në lëvizje, kozmopolite, e cila nuk zë rrënjë në asnjë vend. Keni thënë se, pas vdekjes së burrit, keni jetuar ca kohë në Amerikën e Jugut, në Amerikën e Veriut, në Poloni, në Itali, në Spanjë dhe jo vetëm... Pa përmendur udhëtimet e shumta me jahtin tuaj, të cilin e shitët në 1930. Jeni jashtëzakonisht e pasur. Pasuria juaj vjen një pjesë nga anë e nënës dhe një pjesë prej burrit të vdekur. Në Francë keni banuar disa herë para luftës dhe tani jeni vendosur këtu që prej 1928-ës. Nga viti 1914 deri në vitin 1915, keni jetuar në afërsi të Antibeve. Kjo datë dhe ky vend me siguri ju sjellin ndërmend kujtime të trishta: sepse aty, më 1915, ju vdiq vajza e vetme... Jeta juaj, pas kësaj fatkeqësie, bëhet edhe më tekanjoze, më erratike... Keni pasur lidhje të shumta, që shpejt përfundonin, në atmosferën e volitshme për aventura dashurie të pasluftës. Më në fund, më 1930, në shtëpinë e disa miqve të përbashkët, u njohët me kontin Aldo Monti, pinjoll i një familjeje të vjetër e shumë të respektuar italiane. Konti iu propozoi për martesë. Kishit caktuar dhe datën, apo jo?

– Po, - tha Gledis Eizenahu me zë të ulët.

– Fejesa juaj ishte pothuajse zyrtare. Befas ju e prishët. Për ç'arsye?... Nuk doni të përgjigjeni?... Ndoshta nuk donit të hiqnit dorë nga jeta e lirë dhe e shpenguar që bënit dhe gjithë avantazhet e kësaj lirie. I fejuari juaj u bë dashnori juaj. Saktë?

– Saktë.

– Nuk na rezulton asnjë lidhje tjetër nga 1930-a deri në tetor të 1934-ës. I keni qëndruar besnike kontit Monti për katër vjet. Rasti iu nxori përpara atë që do të bëhej viktimja juaj. Bëhet fjalë për një njëzetvjeçar me origjinë mjaft modeste Bernard Martenin, i biri i një ish-administratori hoteli. Kjo rrethanë, e cila me siguri e lëndonte krenarinë tuaj, është pa asnjë dyshim arsyeja që iu shtyu ta mohoni për një kohë të gjatë lidhjen tuaj me viktimën, ndërkohë që dihej sheshit. Por, ja që Bernard Marteni, njëzet vjeç, student në Fakultetin e Letërsisë në Paris, banues në rrugën Fossés-Saint-Jacques, numër 6, ia doli t’iu shtinte në dorë, juve, një grua mundane, me bukuri të rrallë, e pasur, e lajkatur. Përgjigjuni... I ratë në dorë me një shpejtësi vërtet të pabesueshme, vërtet skandaloze. E korrupuat, i dhatë para dhe, në fund, e vratë. Për këtë krim duhet të përgjigjeni sot, këtu.

E pandehura vuri ngadalë njëra mbi tjetrën duart që i dridheshin; thonjtë iu ngulën thellë në lëkurën e bardhëreme; buzët pa ngjyrë iu hapën paksa, por prej tyre nuk doli as edhe një fjalë, as edhe një tingull.

Kryetari pyeti përsëri:

– Tani tregojuni zotërinjve të jurisë se si e takuat... Nuk dashkeni të përgjigjeni...?

– Ai më ndoqi një natë, - tha më në fund gruaja me zë të ulët, - vjeshtën që shkoi...

Nuk... nuk më kujtohet data... Jo, nuk më kujtohet, - përsëriti disa herë, e tronditur.

– Në hetuesi keni deklaruar datën 12 tetor.

– Mundet, - mërmëriti, - po nuk më kujtohet më...

– Ju... ju propozoi diçka?... Hajt, përgjigjuni... E kuptoj se të rrëfeni këto gjëra është e vështirë, për ju... Dhe, atë natë, shkuat me të.

Ajo nxori një klithmë të dobët:

– Jo! Jo! Nuk është e vërtetë!... Dëgjomëni...

Shqiptoi disa fjalë të mbytura, që nuk i mori vesh askërkush, pastaj heshti.

– Flisni, - tha kryetari.

E pandehura u kthye edhe njëherë nga anëtarët e jurisë dhe nga turma që ia kishte ngulur sytë e etur. Bëri një gjest të lodhur dhe të dëshpëruar dhe, më në fund, psherëtiu:

– Nuk kam asgjë për të thënë...

– Atëherë... përgjigjuni pyetjeve të mia. Atë mbrëmje nuk pranuat të shkonit me të, kështu thatë?... Të nesërmen, më 13 tetor, hetuesia ka mundur të provojë se i keni shkuar në shtëpi, në rrugën Fossés-Saint-Jacques. Saktë?

– Po, - tha gruaja dhe gjaku, që i kishte skuqur faqet ndërsa përgjigjej, zbriti me ngadalë, duke ia lënë të dridhura e verdhane.

– Pra, e kishit zakon t’u shkonit nga pas djelmohave që iu qepeshin në rrugë?... Apo ky iu duk si shumë tërheqës?... S’doni të flisni?... Perdja që mbulonte jetën tuaj private u gris. Këtu, në sheshin publik që është salla e gjykatës, gjithçka duhet të dalë në dritë të diellit...

– Po, - tha gruaja pa pikë fuqie.

– Pra, i shkuat në shtëpi. Po pastaj?... E takuat përsëri?

– Po.

– Sa herë?

– Nuk më kujtohet.

– Ju pëlqente? E dashuronit?

– Jo.

– Atëherë, përse i jepeshit?... Thjesht për hir të vesit?... Nga frika?... I trembeshit ndonjë shantazhi?... Kur ai vdiq, nuk i gjetëm në shtëpi asnjë gjurmë të ndonjë letre nga ana juaj. I shkruanit shpesh?

– Jo.

– Kishit hall mos iu zbulonin?... Se mos e merrte vesh konti Monti këtë shkapërdarje shqisash, këtë aventurë të turpshme? Kështu?... Po ky Bernard Marteni iu donte?... Apo iu vinte rrotull për interes? Nuk e dini?... Epo, të vijmë tek paratë, tani. Ju nuk e keni përmendur këtë rrethanë, për të mos njollosur kujtesën e viktimës, përveçse një herë të vetme, gjatë hetimit, që vetëm rastësia mundi ta zbulonte. Sa para i keni dhënë Bernard Martenit gjatë lidhjes suaj të shkurtër?... Që zgjati saktësisht nga 13 tetori 1934 deri më 24 dhjetor të po këtij viti... I mjeri djalë u vra natën mes 24 dhe 25 dhjetorit 1934. Sa para ka marrë ai prej jush në këta dy muaj?

– Nuk i kam dhënë asnjë shumë parash.

– Po, i keni dhënë. Ne kemi gjetur një çek me emrin tuaj prej pesëmijë frangash, firmosur nga ju, të datës 15 nëntor 1934. Paratë u tërhoqën ditën e nesërme. Nuk e dimë përse u përdorën. I keni dhënë para të tjera?

– Jo.

– Po ne kemi gjetur një tjetër çek, gjithnjë prej pesëmijë frangash... Duket si çmim i përcaktuar më parë... Por, ky nuk u thye.

– E vërtetë, - mërmëriti e pandehura.

– Tani, flisni për krimin... Pra? Fundja, është më lehtë ta tregosh se sa ta kryesh. Atë natë, natën e Krishtlindjeve të shkuara, dolët nga shtëpia juaj në orën tetë e tridhjetë të mbrëmjes, bashkë me kontin Monti. Darkuat me të në restorant, tek Ciro. Më pas e mbyllët mbrëmjen me miq të përbashkët, me Persierët: me Anri Persierin, aktualisht ministër dhe me të shoqen. Të katër shkuat të vallëzonit në një lokal nate, ku qëndruat deri më tre të mëngjesit. Saktë?

– Po.

– U kthyet në shtëpi bashkë me kontin Monti, që iu la përpara derës së shtëpisë. Keni thënë në hetuesi se, kur automobili ndali para banesës, pikasët Bernard Martenin, i cili rrinte fshehur poshtë strehës së derës së hyrjes. Është e vërtetë?... Kishit lënë takim me të atë natë?

– Jo. Kishte disa kohë që nuk e takoja.

– Sa kohë, saktësisht?

– Nja dhjetë ditë.

– Përse? Kishit vendosur të shkëputeshit? Nuk po përgjigjeni? Kur e patë atje në rrugë, atë mëngjes dhjetori, çfarë iu tha?

– Donte të hynte brenda.

– Po pastaj?

– Nuk e lashë. Ishte i dehur. Dukej qartë. Më zuri frika. Kur hapa derën, vura re se po më ndiqte. Erdhi deri te dhoma ime.

– Çfarë iu tha?
– Më kërcënoi se do t'ia thoshte të gjitha... Aldo Montit, të cilin unë e dashuroja...
– Mënyrë e çuditshme për t'i dëshmuar dashurinë!
– E doja! - përsëriti gruaja.
– Po pastaj?
– Kisha shumë frikë. Iu përgjérova. Ai nisi të tallej me mua. Nuk hante arsye... Në atë çast ra telefoni... Vetëm Aldo Monti mundej ose duhej të më telefononte në atë orë... Bernard Marteni më rrëmbeu telefonin... Deshi të përgjigjej. Unë... mora revolen nga komodina pranë shtratit tim. Qëllova... Nuk kuptoja më se çfarë po bëja.
– Vërtet?... Kjo është fraza klasike e të gjithë vrasësve.
– Por, është e vërtetë, - tha Gledis Eizenahu me zë të ulët.
– E zëmë se qenka kështu. Kur e morët veten, çfarë ndodhi?
– Ai shtrihej aty, i pajetë, përpara meje. Fillova ta shkundja, por e kuptova se ishte e kotë.
– Po pastaj?
– Pastaj... shërbyesja thirri policinë. Kaq ishte e gjitha.
– Vërtet? Dhe, kur erdhën policët dhe u zbulua krimi, e pranuat me gjakftohtësi, apo jo?
– Jo.
– Pse, çfarë u thatë?
– U thashë, - u përgjigj Gledis Eizenahu me zë të mbytur, - se, kur hyra në shtëpi dhe po zhvishesha, dëgjova zhurma në banjë, se hapa derën dhe aty pashë një të panjohur.
– Që po vidhte stolitë tuaja, ë? Stolitë që i kishit lënë në tualet, ndërsa po zhvisheshit?
– Po, kështu.
– Gënjeshtër edhe mund të hahej, - tha kryetari duke iu drejtuar anëtarëve të jurisë, - Sepse pasuria, pozicioni shoqëror i së pandehurës, e mbronin lehtësisht nga hijet e dyshimeve... Për fatin tuaj të keq, e pandehur, kur erdhën hetuesit, i kishit ende në trup pallton prej ermelini, fustanin e mbrëmjes dhe të gjitha stolitë... Që të nesërmen ajo u mor në pyetje me mjaft zgjuarsi nga hetuesi. Nuk ngurroj ta përcaktoj dëshminë tuaj një model në llojin e saj. E pandehura është shumë e bukur. Mizore, nuk e vë në dyshim aspak këtë, por shumë e bukur... Dhe e shohim këtë grua të bëjë lëmsh jetën e saj, t'i nxjerrë sytë vetes, siç thuhet në gjuhën e popullit, të hutohet, të gënjejë, të ndryshojë version. Kjo grua betohet – dhe me çfarë toni të sinqertë! – se Bernard Marteni nuk ka qenë kurrë dashnori i saj, këmbëngul kundër çdo fakti, kundër çdo logjike. Qan, lutet dhe më në fund rrëfëhet. Hetuesi, me një analizë të rreptë, finoke, e dend me pyetje dhe më në fund e rindërton aventurën e saj, eh, sa banale... Kjo grua jo më aq e re, e joshur nga mosha e djaloshit, nga shija e së panjohurës, nga aventura, mos vallë edhe nga vetë niveli i ulët i dashnorit?... Ku i dihet?... Ndoshta ishte e lodhur nga dashuriçkat e rangut të saj... I pranon, pastaj kërkon të rikthehet në jetën e përditshme; pandeh, me arrogancën e gruas së pasur, se dashnori, i paguar mirë, do të kënaqet me atë lëmshë, se do të zhduket nga jeta e saj...

Por, të riut, që nuk ka njohur kurrë veç vajza baresh apo prostituta dy lekëshe, i duket e pamundur ta harrojë aq lehtë bukurinë e saj, prestigjin e saj... E përndjek, e kërcënon... Ajo tmerrohet dhe e vret... Dëshmia e saj është vërtet mallëngjyese. Në krye gruaja kërkon t'i vidhet çdo pyetjeje të prokurorit, pastaj pranon, përgjigjet: po, po... Kjo fjalëz rikthehet paprerë. Gruaja nuk shpjegon asgjë. I vjen turp. Gati i bie të fikët nga turpi, si tani, zotërinj anëtarë të jurisë! Por, parashtrimi i krimit të saj, relacioni i hartuar është kaq i vërtetë, kaq i gjallë, kaq logjik, sa nuk mund të mbrohet dot. – Po, - thotë përsëri dhe, – po, – edhe pyetjes shumë të rëndësishme: – A keni vrarë me paramendim? Më pas e ndryshon, duke kuptuar rëndësinë e kësaj përgjigjeje. Ngulmon se e ka vrarë në një moment tronditjeje... Megjithatë, e pandehura, që e ka kaluar jetën deri më tani pa zotëruar ndonjë armë, ja ku na del se, tri javë pasi ka njohur Bernard Martenin, ka shkuar te shitorja e armëve dhe prej atij çasti, nuk e lëshon më nga dora atë revole. Saktë?

– E mbaja në një sirtar pranë krevatit.

– Përse e kishit blerë?

– Nuk e di...

– Përgjigje e paparë... Tani mjaft, na thoni të vërtetën! Po kurdisnit që ta vrisnit Bernard Martenin?

– Jo, ju betohem, - tha gruaja me zë të dredhur.

– Po kujt ia kishit vënë syrin atëherë?... Vetes suaj?... Kontit Monti, për të cilin thuhet se ishte shumë xhelozë për të? Ndonjë rivaleje?

– Jo, jo, - mërmëriti e pandehura dhe fshehu fytyrën në duar. – Mos më bëni më pyetje, se nuk do të them asgjë... I kam thënë të gjitha, gjithçka që donit...!

– Bukur! Vazhdojmë me dëshmitarët. Ftues, të hyjë i pari.

U paraqit një grua; fytyra e saj ngjyrë ulliri ishte vijëzuar nga lotët; i shkëlqenin bebëzat e çuditura të syve, teksa zhvendoseshin nga banka e të pandehurve tek veshja e purpurt e gjykatësve. Përrjashta vazhdonte të binte shi; dëgjohej kërcitja e tij monotone. Një prej gazetarëve, i mërziur, po zhgarraviste fraza romanesh mbi një fletë që mbante përpara: “Era shkëput rënkime të gjata prej lisave të praruar buzë Senës”.

– Emri...?

– Larivierë, Flora, Adelë.

– Mosha?

– Tridhjetë e dy vjeç.

– Profesionit?

– Shërbyesja e parë e zonjës Eizenah.

– Ju nuk mund të betoheni. Do t'iu pyes në bazë të kompetencës sime vetëgjykimore. Kur e keni filluar shërbimin tek e pandehura?

– Më 19 janar bëhen shtatë vjet.

– Na thoni çfarë dini për vrasjen. Zonja juaj duhet të shkonte në një darkë, atë mbrëmje, e shoqëruar nga konti Monti?

– Po, zoti kryetar.

– Ju tha se në ç'orë do të kthehej?

– Tepër vonë, më tha. S’më la ta prisja.
– Ka ndodhur kjo dhe herë të tjera?... Apo zakonisht e prisnit?
– Një muaj më parë u sëmura dhe ndihesha akoma e lodhur. Zonja nuk ishte si shumica e pronareve; ajo kujdesej për personelin. Më tha me zemërgjerësi: – Po lodheni shumë, Flora ime e shkretë. Ua ndaloj të më prisni zgjuar. Do të zhvishem vetë.

- Atë mbrëmje dukej si zakonisht? Ishte e nervozuar? Apo e shqetësuar?
- Vetëm e trishtuar... Trishtohej shpesh. E kam parë më së një herë të qante.
- Dini gjë për arsyen e atyre lotëve?
- Ishte xheloze për zotin kont.
- Vazhdoni aty ku e latë.

– Zonja doli dhe unë shkova e rashë në shtrat; dhoma ime ndodhet në katin e parë, e ndan një korridor nga ajo e zonjës. Më zgjoi zilja e telefonit. Më kujtohet se përmes perdeve hynte drita e agimit; duhet të ishte ora katër ose pesë e mëngjesit. Nganjëherë, kur zonja kthehej, konti i telefononte, si atë mbrëmje. Ndoshta zonja donte të sigurohej se ai kishte shkuar drejt e në shtëpi, pasi qe ndarë prej saj. Në të vërtetë, shpesh ishte ajo që e merrte në telefon, me pretekstin se donte t’ia dëgjonte dhe njëherë zërin. Pra, dëgjova telefonin që po binte, por nuk po përgjigjej njeri. Kjo më shqetësoi pak, pata një parandjenjë të keqe. U ngrita; dola në korridor dhe mbajta vesh. Dëgjova zërin e zonjës sime dhe atë të një burri dhe, pothuajse menjëherë një të shtënë arme.

– Na tregoni ç’ndodhi më pas.

– U tremba pa masë. Vrapova drejt e në dhomën e saj të gjumit, por aty... nuk e di, nuk guxova të hyj... Vura veshin. Nuk dëgjohej më asnjë zhurmë, asnjë frymëmarrje, asnjë pipëtimë... Hapa derën, hyra brenda. Nuk do ta harroj kurrë... Zonja ishte ulur mbi krevat, akoma e veshur, me pallton prej ermeline, me fustanin e mbrëmjes, me stolitë. Një llambë e vogël mbi komodinën e tualetit hidhte pak dritë mbi të. Fytyra e saj ishte tmerrësisht e verdhë. Klitha; e kapa për krahu, i thirra: – Zonjë!... Zonjë!... – dukej sikur nuk dëgjonte gjë. Më në fund, më vështroi e më tha: “Flora, e vrava...”. Mendimi i parë që më përshkoi në atë çast ishte se kishte vrrarë mikun e vet... se ishte grindur me zotin kont dhe se, në një çast turbullire, e kishte qëlluar. Shikova rreth e përçark. Isha kaq e tronditur dhe dhoma ishte kaq pak e ndriçuar, sa në fillim pashë përtokë vetëm një masë të errët, sikur dikush kishte hedhur mbi parket një grumbull rrobash. Ndeza dritën, në një qoshe pashë telefonin që kishte rënë përdhe dhe, pranë tij, revolen. Pastaj pashë një burrë të shtrirë... O Perëndi, u përkula mbi të, nuk i besova syve. Nuk ishte zoti kont, por një djalosh që nuk e kisha parë kurrë...

– Nuk e kishit takuar kurrë më parë viktimën, as në shtëpinë e zonjës suaj as jashtë?

- Kurrë, zoti kryetar.
- E pandehura nuk e ka shqiptuar ndonjëherë emrin e tij para jush?
- Kurrë, zoti kryetar, nuk ia kam dëgjuar asnjëherë emrin.
- Çfarë bëtë kur patë kufomën e atij djaloshit të gjorë?

– Mendova mos merrte frymë akoma dhe ia thashë zonjës. Ajo erdhi dhe u ul në gjunjë pranë meje. Ia ngriti kokën këtij... Bernard Martenit... Ia ngriti dhe ia mbajti disa çaste ashtu, në duar. E shikonte pa folur, pa lëvizur fare dhe, në fakt nuk ishte më e mundur të bëje asgjë. Djaloshit po i rridhte pak gjak nga cepi i gojës. Dukej shumë i ri, i ushqyer keq; ishte i dobët, me faqet e zgavruara dhe rrobat i kishte qull, si të kishte ndenjur për një kohë të gjatë përjashta... Atë natë binte shi... I thashë: – Nuk kemi ç'të bëjmë. Ka vdekur. – Zonja nuk u përgjigj... Dukej sikur nuk ia shqiste dot shikimin... Mori çantën e saj dhe nxori një shami... Ia fshiu cepin e buzëve, gjakun dhe shkumën që i rridhnin të vdekurit nga goja. Mori frymë thellë e më vështroi sikur sapo zgjohej... Më në fund, u ngrit dhe më tha: – Njofto policinë, Flora ime e shkretë... – Ajo e drejtuar me ti... ajo... nuk di të them ç'përshtypje më bëri... Thua se zonja po e kuptonte se nuk do të kishte më kërkënd pranë dhe po më quante pak si një mike...